

**10 vjet**  
**Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

I nderuar z. Dervishi, Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

E nderuar znj. Zv/kryetare e Kuvendit,  
E nderuar znj. Avokate e Popullit,  
Të nderuar Ambasadorë dhe përfaqësues të trupit diplomatik në vendin tonë,  
Të nderuar përfaqësues të institucioneve të vendit,  
Të nderuar pjesëmarrës,

Përshëndetje të gjithëve dhe Gëzuar 10-vjetorin e Institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale!

Institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale sot feston 10-vjetorin, por pa dyshim çështja e transparencës dhe të dhënave personale janë çështje që janë rregulluar prej kohësh në botë, rajon, sikurse edhe në vendin tonë. Pa dyshim, ky rregullim ka kontekstin e vet në kohë e hapësirë. Për shkak të zhvillimeve që kemi përjetuar së fundmi në vendin tonë, të dyja këto çështje kanë kërkuar edhe më shumë vëmendje. Prej pak dekadash, roli i shtetit në rregullimin e jetës në Shqipëri është rrudhur, ekonomia e tregut është një ndër shtyllat themelore të vendit, mpakja e ndikimit të drejtpërdrejtë si aktor aktiv të shtetit dhe dhënia liri veprimi gjithnjë e më shumë privatit janë tashmë në themel të jetës. Ndërkohë, kryesisht falë zhvillimeve teknologjike, përjetojmë një jetesë edhe më intensive, në të cilën jemi të gjithë gjithnjë e më shumë të vëzhguar. Nga ana tjetër, si pjesë e njerëzimit, edhe ne i jemi nënshtruar zhvillimeve globale, si për shembull projekteve të paqes të ndërmarrë kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore dhe që vijojnë ende të zhvillohen më tej, sikurse edhe koncepteve bashkëkohore të administrimit të ri publik sipas të cilave mirë-administrimi pritët nga autoritetet publike. Në kuadër të kësaj të fundit transparenca dhe qeverisja e hapur shihen si gur themeli i një shteti të së drejtës. Situatat që përjetojmë kanë kërkuar apo imponuar që të dhënat tona personale të vendosen gjithnjë e më shumë në hapësirën publike apo në duart e subjekteve të tjera, herë me qëllimin/ndërgjegjen tonë, e herë pa kuptuar apo dashur një gjë të tillë dhe herë sepse kjo na kërkohet me detyrim. Po aq, kërkohet që transparenca e autoriteteve publike të jetë gjithnjë e më shumë qasja e shtetit ndaj interesit publik. Në këtë kompleksitet, detyrimi për të pasur një kuadër të rregulluar normash është pa dyshim i pranishëm, sikurse edhe për të pasur një rol rregullator gjithnjë e më të madh të shtetit.

Në kuadër të këtyre zhvillimeve, ndërmarrja për të përcaktuar fushën e të drejtës për informim, si dhe të mbrojtjes së të dhënave personale, është me rëndësi thelbësore për vendosjen në vendin e duhur të individit dhe subjekteve të tjera përkundrejt interesit publik. Në këtë kontekst, roli i autoriteteve përkatëse është parësor: mënyra si Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është qasur ndaj këtyre çështjeve ka qenë përcaktues për forcimin e respektimit sa të

mbrojtjes të të dhënave personale, aq edhe të transparencës në vendin tonë, duke vënë balancën e duhur mes të dyjave.

Ligjet për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe të drejtës për informim përfshijnë një tërësi parimesh procedurale dhe ngërthejnë një sërë tiparësh simptomatike të fushës. Ndër këto tipare përfshihet edhe tendenca e krijimit të autoriteteve vendase kompetente për këto çështje, Komisionerit në rastin tonë. Një nga risitë e ligjit të vitit 2008 (zëvendësoi ligjin e 1999) në vendin tonë ishte pikërisht krijimi i një strukture të posaçme për të treguar gravitetin e çështjes së mbrojtjes të të dhënave personale. Ndryshimi që erdhi përmes ligjit për të drejtën e informimit të vitit 2014 reflektoi të njëjtin gravitet edhe të çështjes së transparencës dhe informimit. Nisur nga veprimtaria e Komisionerit, angazhimi i këtij të fundit ka rezultuar i suksesshëm deri më tani, ndërkohë që koha imponon një rol edhe më aktiv të këtij autoriteti rregullator në vendin tonë, sidomos duke konsideruar kontekstin kulturor që reflektojmë.

Jo shumë vite kanë kaluar nga krijimi i autoritetit publik të posaçëm që adreson këto dy çështje në vendin tonë, por gjithsesi mjaftueshëm për të reflektuar gravitacionin e pritshëm nga një autoritet publik, si dhe krijuar e forcuar dinjitetin institucional në këto dy fusha. Mund të kujtojmë një sërë situatash të lidhura me të drejtën për informim, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale në vendin tonë, të cilat kanë kërkuar mbajtjen e qëndrimeve ligjore dhe dhënien e zgjidhjeve që fare mirë mund të cilësohen si qëndrime kurajoze. Mund të përmenden çështje si ajo e transparencës së deklaratave të pasurive të subjekteve deklaruese apo e deklaratave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në kuadër të procesit të rivlerësimit të figurës së tyre, apo edhe e punonjësve të administratës publike në vend, ose ajo e përdorimit të sistemit të kamerave nga ana e policisë me qëllim ruajtjen e rendit dhe sigurisë në vend. Në këto çështje Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka anuar balancën nga transparenca dhe jo mbyllja e informacionit, duke kontribuar kështu në forcimin e një qeverisje të hapur dhe shërbim të drejtë ndaj interesit publik, ashtu sikurse vendime të cilat kanë mbështetur mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve në vend, si në rastin e shtrirjes së konceptit të kontrolluesve të të dhënave në të gjithë subjektet private apo edhe ushtruesve të profesioneve të lira në vend, qëndrime këto mjaft të drejta për garantimin e ruajtjes së të dhënave personale si të drejtë themelore të njeriut.

Nëse shohim më gjerë se vendi ynë, mund të thuhet se zhvillimet në fushën e të drejtës për informim dhe privatësisë së të dhënave personale në rajon e më gjerë kanë njohur dimensione të reja. Le të kujtojmë për shembull të drejtën për t'u harruar, vendimin e mirënjohur të Gjykatës së Drejtësisë të BE në çështjen Costeja (ku e drejta për t'u harruar u konsiderua si një e drejtë themelore e njeriut, qasje tashmë solide kjo me vendimin e 13 majit 2014 të GJED) dhe përpjekjen e pasuksesshme të Google për të mos u përfshirë në tërësinë e subjekteve që i nënshtroheshin kësaj qasje të GJED. Ky vendim ishte pa dyshim një zhvillim cilësor në kuadër të garantimit të jetës private në epokën e jetës virtuale të digjitalizuar që përjetojmë. Vendi ynë nuk mund të mbetet jashtë këtyre çështjeve, analizave dhe diskutimeve dhe një rol të rëndësishëm ka autoriteti publik i specializuar në vend për këto çështje. Përpjekjet për të mbajtur qëndrime vendase, në një kontekst global, pa dyshim janë ndërmarrje të komplikuar, por kompleksiteti nuk ka qenë pengesë për Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të reflektuar mbi të tilla çështje. Kështu, ato kanë qenë në themelin e trajnimeve të përbashkëta me Shkollën e Magjistraturës, zhvilluar si bashkëpunim mes aktorëve të akademisë dhe Komisionerit për të Drejtën e

Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe si kontribut i drejtpërdrejtë në formimin e vazhdueshëm profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend.

Nevoja për të vendosur parametra kontekstuale edhe në kuadër të sigurisë së të dhënave, sidomos duke konsideruar teknologjinë, është e pranishme. Nevoja për të mbrojtur dinjitetin njerëzor edhe më shumë dhe vendosur një balancë të drejtë me tij dhe interesit publik, sidomos në kuadër të sigurisë, për të avancuar nga konceptimet tradicionale të privatësisë, duket se herë pas here ngre kokë dhe kërkon rimendim të çështjeve. Në këtë këndvështrim, roli i Komisionerit është pa dyshim parësor. Zhvillime të të dhënave personale që p.sh. BE i reflektoi përmes Rregullores së mbrojtjes së të dhënave personale të BE 2016/679, natyrshëm kërkojnë angazhimin e Komisionerit si autoriteti i specializuar. Në këtë kuptim roli i tij në një prej fushave të lidhur ngushtë me të drejtat e njeriut si dhe shoqërinë e informacionit në vend, mbetet me rëndësi, edhe për të adresuar politikat e integritetit evropian të vendit. Lidhur me këtë të fundit mund të evidentohet se ky institucion ka dhe do vijojë të ketë një rol me rëndësi në plotësimin e detyrimeve të integritetit evropian të vendit tonë, sidomos lidhur me dy prej kapitujve thelbësorë në procesin e integritetit, Kapitulli 23 dhe 24 në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Në kuadër të të drejtave themelore të njeriut që adresohen përmes këtyre dy kapitujve, e drejta për informim dhe të dhënat personale kanë një rol parësor. Respektimi i tyre në nivelin ligjor dhe praktik është në vëmendjen e monitorimit të institucioneve të BE, me qëllim marrjen e vendimeve për avancimin e procesit të integritetit dhe më konkretisht e hapjes së negociatave si hapi i radhës i mirëpritur nga të gjithë në vendin tonë.

Së fundi, ndërveprimi me akademinë ka qenë dhe vijon të mbetet në vëmendjen e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Aktivitete të përbashkëta kanë rezultuar të suksesshme, si konferenca për mbrojtjen e të dhënave personale, angazhime në trajnime të përbashkëta, përfshirje e studentëve në aktivitete të përbashkëta me fokus të drejtën për informim apo mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithsesi, ka vend të thuhet se ka vend për ndërveprim edhe më të shtuar, në të mirë të akademisë dhe vetë punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Mund të thuhet se akademia ka mbajtur një kontribut më shumë retorik lidhur me këto dy fusha, dhe pa dyshim në kësi situatw mund të të lindë pyetja se sa vlerë do kish një kontribut i tillë në një fushë që sa vjen e bëhet më komplekse. Roli i vetë akademisë duhet të jetë edhe më i përforcuar në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtës për informim në vend. Nevoja për të reflektuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën për informim në kurrikula, sikurse edhe për të botuar në këto dy fusha duket si një borxh që pedagogët ende ia kanë ruajtjes së privatësisë dhe konfidencialitetit, si dhe përforcimit të transparencës në vend. Ndërveprimet edhe më të mëdha mes autoriteteve publike, akademisë, si dhe aktorëve të drejtësisë, do ishin në këtë këndvështrim të qenësishme për zhvillimin e duhur të këtyre fushave në vendin tonë. Pa dyshim kjo do ishte në përfitim edhe më të madh të të dy palëve, me qëllim përmbushjen edhe më suksesshëm të misionit të secilës palë.

Së fundi, duke falënderuar edhe një herë për ftesën për të përshëndetur aktivitetin e sotëm që reflekton një përvjetor të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, uroj shumë e shumë përvjetorë të tjerë si dhe vijimin e një roli aktiv të institucionit në vendosjen e balancës së duhur mes ruajtjes së privatësisë në vendin tonë dhe interesit publik, transparencës dhe qeverisjes së hapur,

me qëllim arritjen e një paradigme shoqërore të tillë ku individi ka vendin e vet në qendër të politikave publike.

Suksese në çdo angazhim tuajin dhe tonin të përbashkët!